



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 20/2019 (JR)  
Datë 18.04.2019

Vendim nr. 11 (JR)  
Datë 03.07.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 03.07.2020, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 20/2019 (JR), datë 18.04.2019, që i përket:

**ANKUES:**

Subjekti i rivlerësimit Artan Bajrami, prokuror dhe drejtues pranë Prokurorisë së Apelit për Krimet e Rënda, Tiranë.

**OBJEKTI:**

Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 107, datë 14.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 179/b, A, Ç, D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit,**

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Në lidhje me rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Bajrami (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e prokurorit dhe drejtuesit pranë Prokurorisë së Apelit për Krimet e Rënda, Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
  - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
  - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të

arsyetuar, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami”.

5. Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 107, datë 14.02.2019.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin numër 107, datë 14.02.2019, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami.*  
Komisioni, vendimin e mësipërm, e ka bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c” dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka arritur në konkluzionet e mëposhtme.

*Për vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Artan Bajrami:*

- a. ka deklarim të pasaktë dhe mospërputhje deklarimesh;
- b. ka deklarim të rremë;
- c. ka bërë deklarim të pamjaftueshëm.

*Për kontrollin e figurës, subjekti ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

*Për vlerësimin profesional, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.*

## **III. Shkaqet e ankimit**

8. Në datën 08.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 107, datë 14.02.2019, të Komisionit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
9. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

9.1. Komisioni, në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore që parashikojnë dhe përcaktojnë në ligj kuptimin e togefjalëshave “deklarim i rremë” dhe “deklarim i pasaktë”, ka arritur në konkluzion të gabuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë për pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 111 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë, por pa e argumentuar atë. Për më tepër, ky konkluzion i Komisionit nuk mbështetet në provat që ky i fundit ka administruar gjatë procesit të hetimit administrativ.

9.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar edhe arsyetimin e Komisionit në vendim, sipas të cilit ai me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ ka cenuar dhe “Kontratën e shitjes me kusht” të vitit 2000, pasi në të thuhet se ai ka paguar në arkën e shoqërisë shumë prej 1.300.000 lekësh.

9.3. Komisioni ka shkelur standardet e një procesi të rregullt si pasojë e cenimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u mbrojtur e dëgjuar dhe për të paraqitur argumente dhe prova në kundërshtim të gjetjes së Komisionit për “deklarim të rremë”.

9.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pasaktë gjetjen e Komisionit në vendim lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 55 m<sup>2</sup> dhe verandë 110 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në {\*\*\*}, Kavajë, në lidhje me detyrimin e deklaruar nga ky i fundit ndaj shoqërisë shitëse në vlerën prej 10.000 euro.

9.5. Lidhur me pasaktësitë e kryera prej tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet të mbajë në konsideratë faktin se nuk kanë qenë me qëllim për të mbuluar mungesën e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë, pasi ato kanë qenë nga pakujdesia.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj*

##### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili i merr në shqyrtim ato, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*ii. Legjitimimi i ankuesit*

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 107, datë 14.02.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

13. *Lidhur me shkakun e ankimit për konkluzion të gabuar të Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 111 m<sup>2</sup>, me vendndodhje bulevardi “{\*\*\*}”, Tiranë, ky i fundit pretendon se ky konkluzion nuk mbështetet në provat e administruara gjatë procesit të hetimit administrativ dhe është arritur në saje të interpretimit të gabuar të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi. Më konkretisht:*

13.1. Subjekti i rivlerësimit lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, pretendon se burimi i blerjes së kësaj pasurie, në shumën prej 1.300.000 lekësh, është paguar nga një i afërm i tij, ndërsa pjesa tjetër prej 5.000.000 lekësh është paguar nga subjekti me burim krijimi kredinë bankare. Ky fakt, sipas subjektit të rivlerësimit, i mbështetur dhe nga provat e dorëzuara prej tij në Komision, si: (i) kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.04.1998, e lidhur nga z. P. Ll. A., në cilësinë e porositësit të apartamentit të sipërcituar dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, me anë të së cilës, sipas subjektit të rivlerësimit, provohet blerja e apartamentit nga z. P. A. dhe se pagesa për çmimin e blerjes së apartamentit prej 45.000 USD është kryer prej tij, ndërsa në vijim, në emër të subjektit të rivlerësimit, për llogari të shoqërisë sipërmarrëse ka kaluar vetëm kredia bankare prej 5.000.000 lekësh; (ii) shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 23.02.2016, me të cilat konfirmohet fakti se shuma prej 1.300.000 lekësh është mbuluar nga familja A.; (iii) shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit gjatë hetimit administrativ; (iv) shkresa e lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, datë 29.12.2018, sipas së cilës konfirmohet fakti se shuma prej 1.300.000 lekësh është paguar nga shtetasi P. A. dhe pjesa tjetër prej 5.000.000 lekësh është paguar me kredi nga subjekti i rivlerësimit; (v) deklarata noteriale, datë 29.11.2018, e lëshuar para noterit nga shtetasi Ll. A., në të cilën konfirmohet fakti se shuma prej 1.300.000 lekësh për blerjen e apartamentit të banimit të subjektit të rivlerësimit, është mbuluar prej tij (z. Ll. A.) – provojnë

faktin që nuk ka deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**13.2.** Në mbështetje të pretendimit për konkluzion në interpretim të gabuar të ligjit nga Komisioni, lidhur me deklarimin e rremë nga subjekti i rivlerësimit për burimin e pasurisë së sipërcituar, subjekti argumenton në ankimin e tij:

*Në deklarimin fillestar të pasurisë për vitin 2003, shuma prej 4000 USD e përfituar nga shitja e banesës në Gramsh, është pasqyruar gjendje cash, ndërkohë që po në këtë deklaratë është pasqyruar se është përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 1999. Sikurse kam shpjeguar në vazhdimësi, shuma prej 4000USD është përdorur për prenotimin e apartamentit në {\*\*\*} sipas kontratës së porosisë, datë 18.05.2006; vetë fakti që në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 kam deklaruar se në shumën prej 4000 dollarësh, e përfituar nga shitja e shtëpisë në Gramsh, e kam pasur gjendje cash së bashku me 11000 dollarë kursime dhe po në të njëjtën deklaratë kam deklaruar se kjo shumë (4000 dollarë) është përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, tregon për pakujdesi nga ana ime në plotësimin e deklaratës. Kjo pakujdesi ka vazhduar dhe gjatë plotësimit të deklaratës “vetting”. Por dua të sqaroj se plotësimi në deklaratën “vetting” është bërë duke pasur parasysh që kjo shumë (4000 \$) është përdorur për blerjen e apartamentit në {\*\*\*}, çka e kam vërtetuar dhe me provat paraqitur Komisionit.*

**13.3.** Subjekti në mbështetje të shkakut të ngritur në ankim, pretendon se faktet e cituara më sipër provohen edhe me shpjegimet e dhëna prej tij në ILDKPKI, në datën 23.02.2016, duke konfirmuar sipas tij se shuma prej 1.300.000 lekësh, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2000, është paguar nga familja A.. Sipas subjektit të rivlerësimit: *Këto fakte nuk janë deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ në Komision, siç pretendohet në vendim, por që në procesin e verifikimit që ka kryer ILDKPKI për këtë pasuri në vitin 2016. Kjo rrethanë tregon përsëri mungesën e çdo qëllimi për të paraqitur në mënyrë të pasaktë burimin e krijimit të kësaj pasurie nëpërmjet deklarimit të rremë, pikërisht sepse kjo rrethanë ishte deklaruar para se të niste procesi i rivlerësimit para organit kompetent.*

**14.** Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim: *Në mbështetje të pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe, sipas pikës 3 të po këtij neni, ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Deklarimet e subjektit përpara Komisionit, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, siç është deklarata e shtetasit Ll. A. përpara noterit publik, janë deklarime krejtësisht të ndryshme nga deklarimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë në deklaratën “vetting” në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të këtij aseti. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit në asnjë nga deklaratat periodike vjetore nuk ka deklaruar “dhurimet”, përfshirë dhe dhurimin e shumës prej 1.300.000 lekësh apo prej 1.500.000 lekësh nga shtetasi Ll. A., për të cilën ka deklaruar se ka shërbyer si burim për krijimin e apartamentit, të blerë nga ana e tij në vitin 2000. Si rrjedhim, nuk ka prova që të mbështesin deklarimet e subjektit, të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit. Mosdeklarimi i “dhurimit” si burim në shumën prej 1,5 milionë lekësh në deklaratën “vetting” dhe në deklaratën e vitit 2003, për blerjen e banesës në Tiranë, e vë subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të rremë. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në deklaratën “vetting” mbi burimin e*

*krijimit, për pagesën e këstit prej 1,5 milionë lekësh në blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi në deklaratën “vetting” subjekti ka deklaruar si burim shumën prej 4000\$ nga shitja e apartamentit në Gramsh dhe kursimet ndër vite nga pagat, ndërsa gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore deklaroi se burim janë të ardhurat e dhuruara nga shtetasi LL.A.*

15. Në shqyrtimin e shkakut të mësipërm të ankimit dhe të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, pasi vlerësoi aktet e fashikullit të Komisionit, sa u takon deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e pasurisë objekt gjykimi dhe burimin/burimet e krijimit të saj, konstatoi sa më poshtë.

15.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar vlerën e pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” me sip. 111 m<sup>2</sup>, 45000 USD dhe burimi i krijimit: *1. Sipas kontratës së huasë nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 05.05.2000, për marrje huaje prej 5 milionë lekësh me afat kthimi 25 vjet dhe interes 3% nga Banka e Kursimeve. 2. Të ardhura nga shitja e banesës së përfutur nga privatizimi në Gramsh për shumën 4000 USD, sipas kontratës së shitblerjes, datë 19.11.1996, dhe kursimet ndër vite nga pagat.*

15.2. Në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, subjekti lidhur me pasurinë e paluajtshme në rubrikën “Burimi (konkret dhe jo i përgjithshëm)” ka deklaruar: *Nga Banka e Kursimeve, kredi 5 milionë lekë dhe pjesa tjetër 1,5 milionë, të ardhura në vite, kurse vlera e saj është deklaruar 6,5 milionë lekë.*

15.3. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit lidhur me pyetjen nr. 1, me anë të së cilës i kërkohej të shpjegonte qartë se për çfarë ka shërbyer shuma prej 4000 USD, është përgjigjur më datë 04.12.2018, si vijon: *Dua të sqaroj se shuma prej 4000 USD ka shërbyer për efekte të prenotimit vetëm për momentin fillestar të apartamentit ku banoj, sipas kontratës së porosisë, datë 25.04.1998, të lidhur ndërmjet P. A. (djali i baxhanakut) me shoqërinë e ndërtimit. Me marrjen e kredisë dhe kalimin e kësaj kredie për efekte të blerjes së kësaj shtëpie, shuma prej 4000 USD më është kthyer nga baxhanaku im, z. Ll. A.. Deklaroj me përgjegjësi se unë për blerjen e shtëpisë në Tiranë kam kontribut vetëm shumën e kredisë 5000000 lekë. Pjesa tjetër është mbuluar nga familja A..*

15.4. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është njohur me rezultatet e hetimit dhe se është dakord me to. Ndër të tjera, ka sqaruar: *[...] për pasaktësitë e evidentuara në lidhje me burimin e të ardhurave të deklaruara nga ana ime për pagesën e këstit prej 1,3 milionë lekësh për apartamentin në Tiranë, kjo pagesë është kryer nga shtetasi Ll. A. për shkak të marrëdhënieve të afërta familjare dhe se subjekti ka paguar vetëm shumën 5.000.000 lekë të ardhura nga kredia bankare. Gjithashtu subjekti shpjegon se këto mospërputhje janë pakujdesi të tij në plotësimin e deklaratave të pasurisë.*

16. Në zbatim të parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të detyrimit për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar së bashku me deklaratën e pasurisë kontratën noteriale të shitjes (me kusht) me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.04.2000, në të cilën parashikohet shprehimisht: *Shoqëria ia shet apartamentin z. Artan Bajrami, me një shumë prej 45.000 (dyzet*

*e pesë mijë) USD, ose gjashtëdhjetë e tre milionë lekësh, nga të cilat ka paguar në arkën e shoqërisë 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë, kurse pjesa tjetër do të paguhet nga blerësi në momentin që ai do të marrë kredi nga Banka e Kursimeve, kredi e cila merret në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, pika 5 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve të politikës dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore.*

Referuar përmbajtjes së këtij akti juridik noterial dhe në vlerësimin e tij në lidhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit si në paragrafin 15 më sipër, shumica e trupit gjykues vëren se përveç mospërputhjeve lidhur me vlerën e pasurisë sipas deklaratimit fillestar të vitit 2003 dhe aktit juridik për krijimin e kësaj pasurie, vihen re papajtueshmëri edhe lidhur me pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit për shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit mes parashikimeve kontraktuale dhe deklaratimeve të subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të Komisionit dhe në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit, papajtueshmëri këto të cilat çojnë në mospërputhje mes deklaratimeve ndër vite dhe në deklaratën *vetting* të subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

17. Gjithashtu, referuar akteve të tjera të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe atyre të marra nga ky i fundit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren konkretisht, sa më poshtë.

17.1. Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.04.1998, në nenin 2 parashikohet shprehimisht porositja e apartamentit nga ana e z. P. A. në vlerën prej 45.000 USD, ndërkohë që bashkëlidhur kësaj kontrate është paraqitur një deklaratë e njëanshme e porositësit, z. P. A., i cili referuar nenit 11 të kontratës së sipërcituar, më datë 14.04.2000, heq dorë nga apartamenti i prenotuar, duke zgjedhur si person të tretë për blerjen e tij z. Artan Bajrami. Ndërkohë, referuar sa më sipër, nuk rezulton të jetë bërë mes z. P. A. (porositësit) dhe Shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK (sipërmarrësit) asnjë rakordim lidhur me detyrimet financiare që kanë buruar nga kjo marrëdhënie kontraktuale, sipas parashikimeve të të njëjtit nen të kontratës së sipërmarrjes, duke krijuar paqartësi për trupin gjykues në lidhje me fazën në të cilën ndodhej ekzekutimi i kontratës së porosisë në momentin e lëshimit të deklaratës së z. P. A. më datë 14.04.2000 dhe në vijim, në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes mes shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit, për apartamentin e sipërcituar dhe me çmimin e plotë (të njëjtë me atë të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes).

17.2. Ndërkohë, sa i takon përmbajtjes së shkresës nr. {\*\*\*} prot., të datës 29.12.2018, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, drejtuar Komisionit, në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit, në të cilën thuhet se shuma 45.000 USD është likuiduar fillimisht nga z. P. A. dhe më pas në kuadër të kontratës së shitjes së lidhur me subjektin e rivlerësimit huaja prej 5.000.000 lekë e marrë nëpërmjet kredisë bankare nga subjekti i rivlerësimit është xhiruar në llogarinë bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe i është kthyer nga kjo e fundit z. P. A., trupi gjykues konstaton se kjo shkresë dhe deklaratimet e shoqërisë sipërmarrëse nuk janë shoqëruar me dokumentacion që provon veprimet financiare përkatëse, duke i lënë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në nivelin e deklaratimeve, vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t’u verifikuar.

18. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, me deklaratimet e tij ndër vite dhe ato gjatë procesit të rivlerësimit dhe hetimit administrativ, ka



krijuar një situatë kaotike lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 111 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në bulevardin “{\*\*\*}”, Tiranë, duke bërë të pamundur për trupin gjykues identifikimin e situatës faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie dhe identifikimin e burimeve financiare për krijimin e saj, mbi bazën e së cilës do mund të kryhej kontrolli dhe vlerësimi i kësaj pasurie sipas përcaktimeve në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, si dhe të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie.

19. Pranimi nga ana e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, të gjetjeve të Komisionit lidhur me pasaktësitë e evidentuara dhe pretendimi se deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* lidhur me burimin e krijimit të pasurisë objekt analize është thjesht një pakujdesi, vlerësohet nga trupi gjykues si një pretendim i papranueshëm, për sa kohë ky proces rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë buron nga dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës që përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi, vërtetësi dhe plotësisht pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tyre dhe të personave të lidhur me ta.
20. Ky deklarim i subjekteve shërben si baza nga ku fillon procedura e verifikimit dhe kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit dhe, në këtë kontekst, trupi gjykues arrin në përfundimin se, për sa kohë, si pasojë e deklaramive tërësisht kontradiktore të subjektit të rivlerësimit dhe pranimit nga vetë ai se deklarimi i pasurisë objekt analize në deklaratën *vetting* është i pasaktë, institucionet e procesit të rivlerësimit janë në pamundësi për të verifikuar se cilat ndër deklaramet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e pasurisë në fjalë dhe, për rrjedhojë, është në pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie.
21. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se faktet lidhur me dhurimin nuk janë deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ në Komision, siç pretendohet në vendim, por që në procesin e verifikimit që ka kryer ILDKPKI-ja për këtë pasuri në vitin 2016, duke e pretenduar këtë si rrethanë që tregon mungesën e çdo qëllimi për të paraqitur në mënyrë të pasaktë burimin e krijimit të kësaj pasurie, mbetën në nivelin e pretendimeve të paprovuara, për sa kohë trupi gjykues konstatoi se vetë institucioni që, sipas nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, kontrollon deklaratën e pasurisë, nuk referon në raportin e tij të dhëna të tilla faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë si ai i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit (dhurimi nga familja A. i 1.300.000 lekëve ose 1.500.000 lekë). Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ky fakt nuk është deklaruar për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, por sipas tij është deklaruar edhe pranë ILDKPKI-së më datë 23 shkurt 2016, disa muaj para se të kryhej deklarata e pasurisë *vetting*, e bën akoma më të pabesueshëm pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se pakujdesia e treguar në vitin 2003 në plotësimin e deklaratës fillestare pranë ILDKPKI-së ka vazhduar dhe gjatë plotësimit të deklaratës *vetting*.
22. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, lidhur me kontrollin e kësaj pasurie, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e deklaramit të rremë, por atij të pasaktë, për sa kohë nga analiza e rrethanave faktike si më sipër është e

pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie. Komisioni, në vendimin e tij, nuk ka arsyetuar se përse deklaratime të vërteta mund të jenë ato të bëra në deklaratën fillestare të vitit 2003 dhe jo ato të bëra në deklaratën *vetting* apo të bëra gjatë hetimit administrativ në Komision. Për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, Kolegji vlerëson se institucionet e rivlerësimit e kanë të pamundur të dallojnë se cili deklaratim është i vërtetë dhe cili nga deklaratimet është i pavërtetë, si dhe njëkohësisht e kanë të pamundur të identifikojnë se cili ka qenë shkak i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij.

23. Në këto kushte, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe qëndrimi i tij gjatë hetimit administrativ në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme në pronësi të tij, e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrollit nga ana e institucioneve të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, krijuan bindjen e trupit gjykues se pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklaratimin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
24. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar edhe arsyetimin e Komisionit në vendim, se subjekti me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ ka cenuar dhe “Kontratën e shitjes me kusht” të vitit 2000, pasi në të thuhet se ai ka paguar në arkën e shoqërisë shumë prej 1.300.000 lekësh, duke e mbështetur këtë shkak në faktin e pretenduar se parashikimi në fjalë është rrjedhojë e kontratave tip dhe se nëse kjo shumë do të ishte paguar prej tij, do të ekzistonte edhe mandatpagesa që do të tregonte këtë pagesë, trupi gjykues pas shqyrtimit të përmbajtjes së kontratës së shitjes (me kusht) me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.04.2000, konstaton se sa i takon çështjes së detyrimit të palës blerëse, lidhur me pagesën e çmimit të shitjes, në kontratë janë bërë parashikime konkrete të cilat lidhen me specifikat e rastit objekt gjykimi, siç është fakti se një pjesë e çmimit të shitjes së apartamentit do të mbulohej nëpërmjet kredisë që do të merrte blerësi pranë Bankës së Kursimeve, në kuadër të parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, pika 5 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, duke e vlerësuar edhe kontratën në rastin në fjalë si “kontratë me kusht”. Ky parashikim konkret në kontratë, i cili përkon me përfitimet e subjektit të rivlerësimit sipas legjislacionit të kohës për trajtimin e tij me strehim, vlerësohet si tregues i faktit se parashikimet në kontratën e shitjes në këtë rast nuk kanë qenë rrjedhojë e parashikimeve të kontratave tip, por ato janë hartuar në kuadër të specifikave të rastit konkret. Për rrjedhojë, ky pretendim i ngritur nga subjekti mbeti në nivelin e një pretendimi të paprovuar.
25. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim, sipas së cilit Komisioni ka shkelur standardet e një procesi të rregullt si pasojë e cenimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u mbrojtur e dëgjuar dhe për të paraqitur argumente dhe prova në kundërshtim të gjetjes së Komisionit për “deklarim të rremë”, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në hetimet paraprake nuk

ka evidentuar ekzistencën e deklaramit të rremë për shumën 1.300.000 lekë, madje ky fakt nuk është pretenduar nga Komisioni as në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në kundërshtim me parashikimet e nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk i ka kaluar barrën e provës për të provuar se nuk ka kryer deklaramit të rremë.

26. Në lidhje me shkakun e mësipërm të ankimit, trupi gjykues konstaton se subjektit të rivlerësimit, në kuadër të parashikimeve të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barra e provës lidhur me gjetjet e Komisionit mbi pasaktësitë e evidentuara nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting* krahasuar me deklaramin fillestar në vitin 2003. Në përgjigjet që ka dërguar subjekti i rivlerësimit në lidhje me këto pasaktësi, ai pranon se mospërputhjet ekzistojnë, por justifikohet me pretendimin se ato vijnë si pasojë e pakujdesive të tij në plotësimin e deklaratave.
27. Me kalimin e barrës së provës nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të paraqiste prova dhe shpjegime për të provuar bindshëm të kundërtën e asaj çfarë kishte konstatuar Komisioni, çka në vlerësim të trupit gjykues, në analizë edhe të sa më sipër referuar, nuk u arrit nga subjekti i rivlerësimit, përkundrazi mbeti e paqartë se cili prej deklaramimeve të subjektit të rivlerësimit pasqyron në mënyrë të vërtetë dhe të plotë burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.
28. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të standardit të procesit të rregullt ligjor në drejtim të moskalimit të barrës së provës për kualifikimin ligjor të fakteve si “deklaramit i rremë”, trupi gjykues çmon se me të drejtë subjekti i rivlerësimit duhet të njihej me çdo kualifikim që u ka bërë Komisioni fakteve juridike lidhur me deklaramimet e tij, të cilat sjellin efekte ligjore në të drejtat e tij, por duke mbajtur në konsideratë konkluzionin e arritur më sipër në vendim se, për Kolegjin, subjekti nuk është në kushtet e “deklaramit të rremë”, trupi gjykues çmon se moskalimi nga Komisioni i barrës së provës për “deklaramit të rremë” nuk e ka cenuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artan Bajrami, në kushtet kur barra e provës për deklaramit të pasakta i ka kaluar subjektit të rivlerësimit në mënyrë të qartë dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Për rrjedhojë, në kuadër të sa më sipër, ky shkak i ankimit gjendet i pabazuar për cenimin e vendimit të Komisionit.
29. Lidhur me shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit ai kundërshton si të pasaktë gjetjen e Komisionit në vendim lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sip. 55 m<sup>2</sup> dhe verandë 110 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në {\*\*\*}, Kavajë, në lidhje me trajtimin që Komisioni i ka bërë detyrimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit ndaj shoqërisë shitëse në vlerën prej 10.000 euro, subjekti pretendon se ka dhënë shpjegime të sakta për arsyen e mospagimit të shumës prej 10.000 eurosh, si pasojë e pamundësisë së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme pranë ZVRPP-së nga shitësi. Sipas subjektit, banesa ku ndodhet edhe apartamenti i tij, nuk është regjistruar dhe, në këto kushte, subjekti nuk e ka fituar ende pronësinë dhe për këtë arsye nuk ka detyrimin të paguajë çmimin e plotë të sendit.
30. Lidhur me këtë shkak të ankimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni në arsyetimin e vendimit nuk ka treguar se çfarë pasojë ligjore sjell në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit Artan Bajrami kjo gjetje e tij, duke qenë se për këtë fakt nuk rezulton të jetë bërë asnjë analizë ligjore, si pasojë e së cilës subjektit t’i atribuohet ndonjë shkak konkret për dhënie ndaj tij të masës

disiplinore.

31. Ndërkohë, trupi gjykues konstaton se lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin: *Komisioni ka evidentuar pasaktësi në deklarin për shumën prej 4000 USD, e përfituar nga shitja e apartamentit të tij në Gramsh, pasi në “deklaratën fillestare në vitin 2003” të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në datën 26.03.2004, është deklaruar se ka shërbyer në krijimin e gjendjes së cash-it në shumën prej 15.000 USD, ndërsa në deklaratën “vetting” është deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit në vitin 2000. Për më tepër, subjekti në deklaratën “vetting” ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm të ardhurat nga paga e tij.*
32. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Kolegji ka evidentuar pasaktësi në deklarin për shumën prej 4000 USD, e përfituar nga shitja e apartamentit të tij në Gramsh. Referuar deklaratës fillestare të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në gjendje *cash*, shumën prej 15.000 USD, ku si burim të krijimit të këtij kursi ka deklaruar (i) shumën prej 4000 USD nga shitja e banesës në Gramsh në vitin 1996 dhe (ii) shumën prej 11.000 USD si kursime për periudhën 10 vjeçare, ndërsa në deklaratën *vetting* kjo shumë (4.000 USD) është deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit në vitin 2000. Për më tepër, subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm kursimet në vite nga të ardhurat nga pagat. Gjatë hetimit administrativ, si dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë një version të ndryshëm të fakteve lidhur me përdorimin e shumës prej 4000 USD të përfituar nga shitja e banesës së tij në Gramsh, duke pretenduar se kjo shumë është përdorur për prenotimin e apartamentit në {\*\*\*}, Kavajë.
33. Subjekti në shpjegimet e tij para Komisionit ka sqaruar shprehimisht: *Deklarimi në deklaratën “vetting” se shuma prej 4000 USD është përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, është lajthitje, që mund të ketë ardhur nga pakujdesia gjatë plotësimit të formularit [...].*
34. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues në shqyrtimin e vendimit të Komisionit lidhur me kontrollin e kësaj pasurie, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarin të pasaktë, për sa kohë nga analiza e rrethanave faktike si më sipër, është e pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklarinet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie.
35. Në këto kushte, deklarinet e subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe qëndrimi i tij gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme në pronësi të tij, e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrollit nga ana e institucioneve të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, për rrjedhojë, krijuan bindjen e trupit gjykues se pasaktësitë në deklarinet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarinin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
36. Lidhur me pretendimin e subjektit se Kolegji duhet të mbajë në konsideratë faktin se pasaktësitë e kryera prej tij nuk kanë qenë të qëllimshme, por janë rezultat i pakujdesisë dhe duhet të shihen

në raport me rezultatet e hetimit administrativ ku subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe aftësive profesionale për një karrierë të gjatë si prokuror, trupi gjykues çmon se pasaktësia në deklarime për kriterin e pasurisë, nuk ka asnjë lidhje me dy kriteret e tjera të rivlerësimit, për sa kohë kontrolli i një kriteri nuk ndikohet nga rezultati i kontrollit të një kriteri tjetër, pasi ata vlerësohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, duke çuar në një rezultat të caktuar.

37. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta, fakt ky që pamundësoi kontrollin në tërësi dhe objektiv të kriterit të pasurisë dhe, si rrjedhojë, pamundësoi arritjen prej tij të një niveli të besueshëm lidhur me vlerësimin e pasurisë së tij.
38. Në këto kushte subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke e bërë atë të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe, si rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 107, datë 14.02.2019, lidhur me dhënien e masës disiplinore është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 107, datë 14.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Artan Bajrami.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.  
U shpall më datë 03.07.2020, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi - kundër*

**ANËTAR**

**Luan DACI**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi - kundër*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Ardian Hajdari, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami kundër vendimit nr. 107, datë 14.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), vendim i cili e ka shkarkuar atë nga detyra.
2. Në konkluzion të qëndrimit tonë, kemi votuar kundër vendimit nr. 11, datë 03.07.2020, të marrë prej shumicës së trupit gjykues për lënien në fuqi të vendimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur qëndrimin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi duhej të ndryshohej në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami.  
Në arsyetimin tonë të qëndrimit kundër më poshtë, do të shpjegohen shkaqet për të cilat vota jonë ishte në favor të ndryshimit të vendimit të Komisionit, në ndryshim nga ajo që votoi shumica e trupit gjykues, duke përjashtuar nga arsyetimi argumentet që janë në të njëjtën linjë dhe dakordësi me shumicën e trupit gjykues e që lidhen me problematikat e evidentuara nga Komisioni në raport me mosshlyerjen ende të detyrimit prej 10.000 eurosh, si pjesë e çmimit të blerjes së një apartamenti të ndodhur në {\*\*\*}, Kavajë, për të cilat ndajmë të njëjtin qëndrim si shumica, se faktet e konstatuara nuk mund t’i atribuohen ndonjë shkeljeje ligjore të tillë që të jetë e mundur të identifikohet si një shkak që mund të ngrihet në nivelin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ndonjë nga parashikimet e nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5 e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
3. Në vlerësimin tonë, nga analiza e fakteve të cilat përshkruhen edhe në arsyetimin e vendimit të shumicës, rezultojnë dy të dhëna që duhet t’i nënshtrohen vlerësimit të gjykatës në kuadër të shqyrtimit të vendimit objekt i këtij gjykimi.
  - *Së pari*, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka cituar në deklaratën *vetting* si burime për krijimin e pasurisë apartament të blerë në vitin 2000, kredinë prej 5.000.000 lekësh, shumën prej 4.000 USD të përfituar prej shitjes së pasurisë apartament në Gramsh në vitin 1996 dhe kursimet nga pagat.
  - *Së dyti*, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka modifikuar këtë deklaram duke shpjeguar se si burim krijimi i pasurisë apartament në Tiranë ka shërbyer kredia prej 5.000.000 lekësh, e përfituar nga Banka e Kursimeve, dhe shuma prej 1.300.000 lekësh, e përfituar si dhuratë nga z. Ll. A., baxhanaku i subjektit. Ndërsa shuma prej 4.000 USD është përdorur si burim për krijimin e shumës kursime prej 15.000 USD, të deklaruar në vitin 2003 e të përdorur në vitin 2006 si burim për krijimin e pasurisë apartament në {\*\*\*}, Kavajë.
4. Ndajmë të njëjtin qëndrim si shumica në lidhje me konsiderimin e këtyre deklarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit administrativ në mënyrë jokohërente në raport me ato të deklaruara në deklaratën *vetting* e ato të deklaruara në deklaratat periodike të pasurive për vitet 2003 e 2006, si deklarime të pasakta të subjektit të rivlerësimit dhe jo si deklarime të rreme siç kishte konkluduar Komisioni në vendimin e tij.

5. Krahas argumenteve të përdorura nga shumica për arritjen e këtij konkluzioni, pakica çmon të nënvizojë edhe faktin se përveç mungesës së koherencës në këto deklarime, nuk konstatohet asnjë veprim apo përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave, të cilat do ta shpëtonin atë nga ndonjë situatë paligjshmërie që lidhet me justifikimin e burimeve të ligjshme të pasurisë së tij. Për pasojë, duke pasur këtë rrethanë faktike në konsideratë, pakica çmon se subjekti nuk gjendet në kushtet e një deklarimi të rremë, pasi nuk plotësohen kriteret e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, të cilat zbërthehen më tej në nenin 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.
6. Duke ndjekur arsyetimin e mësipërm dhe duke pranuar si shumica e trupit gjykues se situata faktike e mospërputhjeve e mungesës së koherencës duhet trajtuar si një pasaktësi në deklaram, dhe se ajo duhet trajtuar në kuadër të interpretimit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, kemi vlerësuar se për të matur peshën e kësaj shkeljeje në procesin e rivlerësimit dhe në drejtim të afektimit të mundshëm prej saj të vendimmarrjes së trupës, ajo duhet të analizohet në harmoni e raport me situatën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe aftësinë e tij për të përballuar me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurisë apartament të ndodhur në Tiranë dhe të shumës prej 15.000 USD kursime, në të cilën janë përdorur si burim të ardhurat e cituara më lart.
7. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare për të përballuar me burimet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* – kredi prej 5.000.000 lekësh, shuma 4000 USD dhe kursime familjare – financimin e apartamentit të banimit të ndodhur në Tiranë.  
Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, subjekti ka rezultuar me mjaftueshmëri financiare edhe për të përballuar financimin e këtij apartamenti edhe sipas deklaramit të burimeve në deklaramin fillestar të pasurisë vitin 2003, kredi dhe kursime familjare.
8. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mjaftueshmërisë financiare për të përballuar financimin e apartamentit në Tiranë, edhe sipas deklaramit të bërë gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të cilit shumën prej 1.300.000 lekë apo 1.500.000 lekë<sup>1</sup>, e ka financuar z. Ll. A. nëpërmjet dhurimit të kësaj shume në favor të subjektit. Komisioni dhe Kolegji kanë konkluduar për mundësitë e z. A., me cilësinë e personit tjetër të lidhur, për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e kësaj shume në zbatim të detyrimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
9. Pavarësisht analizës së mësipërme, pakica çmon se duke vlerësuar çdo të dhënë që është përfituar nga hetimi administrativ, arrihet në konkluzionin se z. Ll. A. ka kontribuar në financimin e këtij apartamenti në favor të subjektit në shumën prej 1.300.000 lekë.
10. Ky konkluzion vjen mbështetur në analizën e renditjen në një linjë logjike edhe të fakteve të tjera që kanë rezultuar nga hetimi. Sipas këtij arsyeimi, në drejtim të verifikimit të vërtetësisë së deklaramit të subjektit për dhurimin e kësaj shume, shkojnë të dhënat që përftohen nga një sërë aktesh si vijojnë.

---

<sup>1</sup> Diferencë që vjen për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit meqenëse pagesa është bërë në USD.

i) Kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.04.1998, në nenin 2 të së cilës parashikohet shprehimisht porositja e apartamentit nga ana e z. P. A.<sup>2</sup> në vlerën prej 45.000 USD.

ii) Deklaratë e porositësit z. P. A., datë 14.04.2000, i cili referuar nenit 11 të kontratës së sipërcituar, heq dorë nga apartamenti i prenotuar, duke përcaktuar si person të tretë për blerjen e tij z. Artan Bajrami.

iii) Kontratën noteriale të shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.04.2000, në të cilën parashikohet se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ia shet apartamentin z. Artan Bajrami me një shumë prej 45.000 (dyzet e pesë mijë) USD.

iv) Shkresa nr. {\*\*\*} prot., e datës 29.12.2018, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, drejtuar Komisionit, në të cilën specifikohet se në bazë të kontratës së sipërmarrjes mes kësaj shoqërie dhe z. P. A., është likuiduar shuma 45.000 USD nga z. A., dhe më pas nga ky i fundit është kërkuar që kontrata e shitjes të bëhet mes shoqërisë dhe z. Bajrami dhe pagesa e marrë kredi nga z. Bajrami iu kthye nga shoqëria z. A.. Kjo përmbajtje tregon se diferenca e çmimit të shitjes ka mbetur e likuiduar për llogari të shoqërisë ajo që është likuiduar prej z. A. sipas kontratës së sipërmarrjes së cituar më lart.

v) Sipas procesverbalit, datë 23 shkurt 2016, i mbajtur pranë ILDKPKI-së, gjatë një praktike verifikuese, subjekti, pasi ka shpjeguar marrëdhënien e tij me familjen A., ka deklaruar se nga totali prej 45.000 USD ( 6.300.000 lekësh) të paguar për këtë apartament prej kësaj familjeje, kontributi i vetëm i subjektit është në vlerën prej 5.000.000 lekësh.

11. Të gjitha të dhënat e mësipërme, në vlerësimin tonë e bëjnë të besueshëm deklarinin e subjektit të rivlerësimit, i cili nuk shfaqet për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, por ka qenë gjithashtu i shprehur, në të njëjtat terma e në të njëjtin kontekst, edhe tre vjet para se të zhvillohej procesi i rivlerësimit, me deklarinimet e dhëna në organin përgjegjës për verifikimin dhe kontrollin e pasurive të subjekteve deklaruese.
12. Mbështetur në argumentet e mësipërme, kemi vlerësuar se pakujdesia e treguar nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e deklaratës *vetting*, duhet çmuar në harmoni me konkluzionin se situata e tij financiare rezulton pozitive, sipas vlerësimit të kryer në Kolegj, në çdo version të deklarinimit të tij për burimet e financimit të pasurive dhe se qasja dhe sjellja e subjektit në raport me deklarinin, demonstroi vetëm neglizhencë e pakujdesi, pa u evidentuar ndonjë përpjekje për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë pasurinë.
13. Gjithashtu vlen të nënvizohet fakti se kjo pakujdesi mbetet e vetmja gjetje e evidentuar nga procesi i rivlerësimit të subjektit Artan Bajrami. Nga ky proces i zhvilluar ndaj tij nuk rezultojnë shkelje të tjera, të cilat do të duhej të vlerësoheshin në raport me këtë situatë. Duke qenë e vetmja shkelje e cila është kualifikuar si pakujdesi edhe nga shumica e trupit gjykues, edhe nga ne si pakicë, referuar edhe qëndrimeve të mbajtura tashmë në mënyrë të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>3</sup>, për sa kohë që nuk shoqërohet me mungesë të burimeve

---

<sup>2</sup> Djali i dhuruesit, z. Ll. A..

<sup>3</sup> Vendim nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019; vendim nr. 9/2020 (JR), datë 26.06.2020.



financiare të ligjshme për të krijuar pasurinë, ajo nuk mund të përdorej si një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit.

Në konkluzion të këtij arsytimi, pakica çmon se pasaktësitë e konstatuara si më lart, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për çdo alternativë të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shërbejnë si një shkak për të kolauduar se vlerësimi tërësor i pasurisë së tij ka problematika nga ato që parashikon neni D i Aneksit Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14. Sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka detyrimin të provojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurisë së tij dhe në rastin konkret, pakica vlerëson se subjekti e ka kaluar me sukses këtë test, në secilën prej alternativave që do përdoshin për burimet e deklaruara prej tij. Në këto kushte, ai nuk gjendet në kushtet e parashikimit të nenit 3, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që situata e tij financiare paraqitet gjithmonë pozitive.

Gjithashtu, pakica vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk u konstatua se kishte bërë përpjekje për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij, për pasojë ai nuk u gjend as në parashikimet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në parashikimet e nenit 33, pika 5, germat “c” e “ç” të ligjit nr. 84/2016 që përcaktojnë situatat e fshehjes së pasurisë apo deklarimit të rremë.

15. Në përfundim të këtij arsytimi, pakica ka çmuar se nuk gjen zbatim në rastin konkret parashikimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 që detyron vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke qenë se nuk ekziston asnjë nga situatat referuese të nenit 33, sipas përcaktimeve të këtij shkak shkarkimi.

16. Përveç sa më sipër, pakica çmon të nënvizojë se, edhe sikur pasaktësitë e konstatuara të vlerësoheshin përtej kriterit të pasurisë, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përsëri do të gjendeshim në situatën kur kjo shkelje do të mbetej e vetmja e konstatuar për këtë proces, duke qenë se subjekti ka rezultuar i përshtatshëm në drejtim të kontrollit të kriterit të figurës pas vlerësimit të institucionit të DSIK-së dhe hetimit të kryer në Komision, si dhe i aftë profesionalisht në drejtim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, pas raportit të dërguar prej strukturës përgjegjëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni. Për më tepër, nuk ka rezultuar asnjë denoncim, informacion apo indicie qoftë edhe indirekte për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë për shkak të performancës profesionale e jashtëgjyqësore të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht karrierës së tij të gjatë 40-vjeçare në organet e drejtësisë, aq më tepër në një pozicion të ekspozuar ndaj krimit të organizuar, siç është drejtimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për 15 vite.

17. Në këto kushte, pakica çmon se edhe në këtë këndvështrim, do të gjendej i drejtë konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, për shkak se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterëve të pasurisë e figurës, si edhe një nivel kualifikues në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Për të gjitha sa më lart, kemi votuar për ndryshimin e vendimit nr. 107, datë 14.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Bajrami.

**GJYQTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*